



Plani Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë

2019-2020



*Çfarëdo mendon të bësh, apo e ke ëndërr, filloje. Guximi ka gjenialitet,
pushtet dhe magji brenda! Filloje tani!*

— Gëte

HYRJE

Në vitin 2016, Shqipëria miratoi reforma kushtetuese dhe legislative gjithëpërfshirëse, me qëllim forcimin e integritetit dhe qeverisjes së gjyqësorit në vend. Këto reforma përcaktonin edhe ngritjen e institucioneve të reja, përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi vetëqeverisës i gjyqësorit në Shqipëri, i cili u krijua në dhjetor të vitit 2018. Mes funksioneve të shumta, Këshillit i kërkohet të bëjë planifikimin strategjik, në emër të të gjithë gjyqësorit.

Ky plan strategjik u hartua nga KLGJ-ja, në këshillim me një gamë të gjerë aktorësh dhe palësh interesi duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë. Plani strategjik është në harmoni të plotë me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SNSD) dhe legjislacionin shqiptar.

Anëtarët e KLGJ-së kanë përgjegjësi të plotë për përcaktimin e qëllimit, vendosjen e prioriteteve, dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për përmbushjen e vizionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dëshiron të shprehë një falënderim të veçantë për Ministren e Drejtësisë dhe ekipin e saj, të cilët kanë punuar në konsultim të ngushtë me Këshillin për t'u siguruar që Plani Strategjik të ishte në përputhje të plotë me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe prioritetet e tjera të ministrisë. Kjo punë përfaqëson një nivel bashkëpunimi midis Gjyqësorit dhe Ministrisë që nuk ishte parë kurrë deri më sot, dhe garanton që çdo aspekt i sistemit të drejtësisë në Shqipëri të veprojë në mbrojtje të interesave më të larta të popullit shqiptar.

HISTORIKU

Që prej fundit të vitit 2014, Shqipëria ka nisur dhe ka zbatuar një reformë tërësore të sektorit të drejtësisë, për të trajtuar një sërë çështjesh me rëndësi:¹

- Perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë;
- Mungesën e koherencës në legjislacion;
- Performancën e dobët të institucioneve në sistemin e drejtësisë;
- Çështjet e lidhura me ndarjen e pamjaftueshme të pushteteve midis ekzekutivit dhe gjyqësorit;
- Kriteret dhe procedurat për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, si dhe për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm;
- Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve aktualë;
- Procesin e realizimit të masave disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët;
- Kapacitetet e mangëta administrative në sektorin e drejtësisë;
- Buxhetin e pamjaftueshëm për infrastrukturën e gjykatave dhe pagat e gjyqtarëve;
- Edukimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Nivelet e larta të korrupsionit në gjyqësor; si dhe
- Shpërndarjen e pabarabartë të ngarkesës së çështjeve në shkallë të ndryshme të gjyqësorit dhe midis gjykatave të së njëjtës shkallë.

¹ “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, Qershor 2015

Dokumenti kyç i politikave qeveritare që përcakton kuadrin e zbatimit të reformës në drejtësi është **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2020 (SNSD)** dhe Plani përkatës i Veprimit, që janë miratuar nga Këshilli i Ministrave në nëntor të vitit 2016. SNSD-ja përcakton afatet kohore për zbatimin e këtyre veprimeve, së bashku me përllogaritjet financiare të kostove që nevojiten për përmbushjen e përpjekjeve të reformës.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë e trajton reformën në drejtësi sipas këtyre pesë fushave:

- Forcimi i pavarësisë, efektshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor;
- Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut;
- Forcimi i rolit të profesioneve të lira; si dhe
- Garantimi i rolit aktiv të palëve të interesit (përfshirë shoqërinë civile) në përpjekjet e reformës.

Dy janë aspektet e SNSD-së që e përkufizojnë atë si dokument: a) duke qenë një strategji sektoriale, ajo e trajton reformën në drejtësi bazuar në synime dhe veprimtari të përcaktuara përgjithësisht, dhe b) si një dokument politikash i miratuar nga qeveria, strategjia e kufizon veten vetëm në etapat madhore të reformës në drejtësi dhe nuk mund të trajtojë detajet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë (pra, edhe përcaktimin e kufijve në ndarjen e pushtetit midis ekzekutivit dhe gjyqësorit). Ky i fundit është objekti dhe detyrimi i planit strategjik të KLGJ-së. Sidoqoftë, këto dy dokumente strategjike janë të lidhur me njëri-tjetrin në mënyrë funksionale. Kështu, veprimtaritë e SNSD-së, për zbatimin e të cilave është KLGJ-ja autoriteti përgjegjës, janë përvetësuar dhe kthyer në disa prej objektivave të planit strategjik të KLGJ-së. Më tej, këto objektiva zërthehen me hollësi në veprime me pikësnyime. Plani strategjik i KLGJ-së plotësohet më tej me objektiva dhe veprime të tjera, që do të shërbejnë si bazë për punën e ardhshme të KLGJ-së. Kjo qasje garanton lidhjen midis dy dokumenteve strategjike. KLGJ-ja është përgjegjëse për zbatimin në ato fusha të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë që lidhen me forcimin e pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies në sistemin e gjykatave, përfshirë këtu përmirësimin e statusit të gjyqtarit, rritjen e aksesit në drejtësi, përmirësimin e infrastrukturës së sistemit gjyqësor dhe sigurimin e një sistemi të përshtatshëm për administrimin e çështjeve gjyqësore në gjykata.

SNSD-ja dhe Plani Strategjik i KLGJ-së janë të lidhur me përparësitë e politikave kombëtare të përshkruara në një sërë strategjish dhe dokumentesh të politikave. Ato trajtojnë objektivat e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim**, e cila synon të “ndërtojë një vend i cili bazohet në sundimin e ligjit dhe garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përmes një sistemi të hapur dhe të barabartë drejtësie”, si dhe objektivat e **Planit Kombëtar për Integrim Evropian 2017-2020**, që krijon “një sistem drejtësie të pavarur, llogaridhënës dhe efikas në Shqipëri, që është i aftë të japë drejtësi në mënyrë të paanshme dhe transparente”.

Ato gjithashtu, trajtojnë të metat e theksuara në **Progres Raportin e fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë** lidhur me ngritjen e institucioneve të pavarura gjyqësore dhe ndjekjen e një qasjeje sektoriale ndaj reformës në drejtësi, sipas strategjisë ndërsektoriale 2017-2020. Këto raporte synojnë të garantojnë një qeverisje, monitorim dhe raportim të përshtatshëm, të shoqëruar me mbështetjen e duhur financiare për zbatim. Së fundmi, si SNSD-ja, ashtu edhe Plani Strategjik i KLGJ-së, lidhen edhe me **Strategjinë e Reformës në Administratën Publike** për sa i përket reformës në shërbimin civil.

Përpara reformës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ishte një organ i pavarur, përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin dhe vlerësimin profesional të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit. Në kuadrin e procesit të reformës, stafi i Këshilli të Lartë të

Drejtësisë (KLD) dhe i Zyrës për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ) u bashkuan duke u bërë pjesë e strukturës së **Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ)**.

KLJG-ja është tashmë organi qeverisës i të gjithë gjyqësorit, përfshirë Gjykatën e Lartë.

KLJG-ja është përgjegjëse për zbatimin e atyre fushave të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë që lidhen me forcimin e pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor, përfshirë këtu përmirësimin e statusit të gjyqtarit, rritjen e aksesit në drejtësi, përmirësimin e infrastrukturës së sistemit gjyqësor dhe sigurimin e një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e çështjeve gjyqësore në gjykata.

Miratimi i paketës ligjore të reformës në drejtësi në vitin 2016, veprim që çoi në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, erdhi për arsye se mbarë vendi njohu nevojën për ndryshime të thella e tërësore të sistemit të drejtësisë.

PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Dy vjet pas miratimit të reformës në drejtësi, krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor në dhjetor të vitit 2018, shënoi një kthesë në drejtimin dhe riorganizimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Menjëherë pas krijimit, KLJG-ja nisi mbledhjet e vazhdueshme për të ravigjzuar veprimtarinë, vendimmarrjen, si dhe monitorimin e vlerësimin me qëllim hartimin e planit strategjik. KLJG-ja e kupton urgjencën e momentit dhe është e angazhuar të veprojë shpejt dhe me efikasitet, në interes të qytetarëve shqiptarë.

Në planifikimin e drejtimit strategjik të gjyqësorit për dy vitet e ardhshme, Këshilli ndërmori në analizë të detajuar të faktorëve të brendshëm dhe ndikimet e tyre të jashtme të mundshme të faktorëve jashtë kontrollit të tyre dhe se si këta faktorë mund të ndikojnë në aftësinë e Këshillit për të përmbushur synimet dhe objektivat e përcaktuara në këtë strategji.

Gjatë dy viteve të para, KLJG-ja është e angazhuar të ndërmarrë rolin e vet si udhëheqëse e gjyqësorit shqiptar. Këshilli do të vijojë të fokusohet më qartë dhe do të bëjë zgjedhje strategjike për të zgjidhur problemet më domethënëse, me të cilat përballet sistemi gjyqësor shqiptar.

Duke e kuptuar qartë rolin vendimtar, Këshilli ndërmori një proces dinamik planifikimi strategjik, për të përcaktuar një të ardhme ku qytetarët, gjyqësori dhe qeverisja të bashkërendojnë përpjekjet për të forcuar politikën dhe praktikën gjyqësore në vend, si dhe për të arritur rezultate që krijojnë siguri dhe besim te publiku.

Rrjedha e strategjisë, e paraqitur më poshtë, dhe parametrat për mënyrën e re dhe të frytshme të punës, u përcaktuan nga një grup i ndërthurur pjesëmarrësish nga KLJG-ja dhe gjykatat, përmes një procesi angazhimi dhe këshillimi.

KLJG-ja do të mbështetet në një punë të vazhdueshme dhe transparente duke përfituar nga përvoja dhe eksperiencia e gjerë e anëtarëve të saj si dhe konsultimet me institucionet e interesuara me synim zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e praktikave gjyqësore ndërkombëtare më efikase. Në të njëjtën kohë, KLJG-ja do të mbajë në fokus përshtatjen e matur të instrumenteve të testuara në vendet e tjera për të adresuar problemet dhe nevojat që do të evidentohen në mënyrë konsekuente e periodike.

KLJG-ja do të luajë rol thelbësor, si një zë për sundimin e ligjit, duke mbështetur reformat e duhura të bazuara në vlera, në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Këshilli është i zotuar të punojë në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, Qeverinë e Shqipërisë, partnerët për zhvillim,

gjqetarët, dhe pa dyshim, me qytetarët, për të bërë investime strategjike që sjellin një sistem gjyqësor efikas dhe që gëzon respekt.

Gjatë punës për hartimin e këtij plani, KLGJ-ja diskutoi dhe mori në konsideratë, ndër të tjera, çështje si: 1) reputacionin historik të gjyqësorit, 2) ngarkesën e prapambetur prej 30.000 çështjesh të Gjykatës së Lartë dhe mosfunksionimin e saj, 3) ritmet e ndryshimeve teknologjike, 4) kufizimet buxhetore dhe nevojat infrastrukturore, 5) mangësitë serioze në burime njerëzore, 6) shkallën e financimeve në të ardhmen nga partnerët për zhvillim, si dhe çështjet e lidhura me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Efektet e mundshme të këtyre çështjeve në të ardhmen e gjyqësorit janë marrë parasysh në këtë plan strategjik.

Së fundmi, KLGJ-ja ka pritshmërinë se planet e veprimit do të kenë nevojë të evoluojnë, përshtaten dhe ndryshojnë, ndërkohë që profesionistë të talentuar punësohen dhe nisin ta zbatojnë këtë strategji. KLGJ-ja ka miratuar këtë plan dyvjeçar për të trajtuar nevojat emergjente të gjyqësorit, duke parashikuar të ndërmarrë një proces akoma më të gjerë e trevjeçar planifikimi, në mesin e vitit 2020.

Përkufizimi i Termave të Planifikimit Strategjik

Vizioni

Deklarata e vizionit sheh nga e ardhmja dhe ofron imazhin e gjendjes ideale që institucioni dëshiron të arrijë.

Vizioni duhet t'i frymëzojë njerëzit që TË ËNDËRROJNË.

Deklarata e Misionit

Një përshkrim i shkurtër dhe lehtësisht i kuptueshëm, zakonisht i formuluar në pak fjalë. Ajo përcakton qëllimin bazë të KLGJ-së dhe është në përputhje me vlerat, programet dhe veprimtaritë themelore të institucionit, të shprehura brenda kontekstit të gjerë të problemeve, nevojave dhe sfidave në rang kombëtar.

Misioni duhet t'i frymëzojë njerëzit që TË VEPROJNË.

Vlerat

Vlerat e një institucioni janë parimet e tij udhëheqëse, janë një kod sjelljeje, ose kod kulture, që shpjegon se si institucioni synon të funksionojë, në përputhje me këto vlera.

Deklarata e vlerave bën një premtim.

Kaskada e Strategjisë

Kaskada e Strategjisë përfaqëson përgjigjet për pesë pyetjet thelbësore dhe të ndërlidhura mes tyre. Kjo qasje kërkon edhe ekselencë, edhe llogaridhënie. Ajo i kërkon institucionit të jetë shumë i qartë lidhur me propozimin unik për vlerën që do të sjellë, pra, një deklaratë e qartë që përshkruan përfitimet që sjell puna e tij, mënyrën e përmbushjes së nevojave të palëve të interesit, si dhe çfarë e dallon institucionin nga të tjerët.

Synimet Strategjike

Formulime që shprehin rezultate të përgjithshme afatgjata që KLGJ-ja synon të arrijë në drejtim të funksioneve dhe veprimtarisë kryesore. Ato trajtojnë ndikimin e gjerë që KLGJ-ja dëshiron të arrijë.

Objektivat Strategjikë

Formulime që pasqyrojnë ndikimin specifik që KLGJ-ja synon të arrijë, në kuadër të një synimi të përcaktuar. Objektivat janë të lidhur me një grup synimesh dhe treguesish të performancës, që janë përcaktuar për ta ndihmuar Këshillin të monitorojë dhe kuptojë ecurinë.

Veprimtaritë

Formulime që përshkruajnë qasjet ose praktikatat që institucioni planifikon të ndjekë për të përparuar me objektivat.

Afati Kohor

Një përshkrim realist (e megjithatë ambicioz) i sasisë së kohës që nevojitet për përmbushjen e një objekti.

Partnerë të Jashtëm Kyç

Qeveria dhe agjenci private, organizata, partnerë për zhvillim (donatorë), apo subjekte që kontribuojnë për arritjen e objektivave të KLGJ-së.

Treguesit

Instrumente matëse të përgjithshme që tregojnë nëse arritja e rezultateve të dëshiruara është në drejtimin e duhur.

Matjet

Instrumente matëse që ndihmojnë në përcaktimin e ndikimit që kanë veprimtaritë mbi rezultatet. Me to lidhen disa pikësnyime specifike dhe mund të jenë sasiore ose cilësore.

PLANI STRATEGJIK 2019-2020

VIZIONI

Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.

MISIONI

Misioni i KLGJ-së është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

VLERAT THEMELORE TË GJYQËSORIT

Pavarësia - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem gjyqësor që funksionon si një organ i pavarur, i pandikuar nga ndërhyrjet dhe i angazhuar ndaj sundimit të ligjit.

Integriteti - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem të ndershëm gjyqësor që vepron në përputhje me parimet më të larta morale dhe etike dhe që gjithmonë përpiqet të bëjë drejtësi.

Profesionalizmi - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem gjyqësor, anëtarët e të cilit i zotërojnë të gjitha aftësitë e nevojshme për të përmbushur më së miri rolin e tyre.

Paanshmëria - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të trajtojnë të gjithë qytetarët si të barabartë përpara ligjit.

Llogaridhënia - KLGJ-ja dhe gjykatat zotohen të garantojnë që të gjithë anëtarët e gjyqësorit janë të gatshëm të marrin përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre.

Përveç vlerave themelore të KLGJ-së dhe gjykatave, vendimmarrja e përditshme në gjyqësorin shqiptar mbështetet edhe në parimet e rëndësishme në vijim:

Aksesi, Efektshmëria, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Trajtimi i Drejtë, Besueshmëria, Respekti, Përgjegjshmëria dhe Transparenca.

Rrjedha e Strategjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor të Shqipërisë

VIZIONI i KLGJ-së: Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.



Misioni i KLGJ-së është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

Palët e Interesit: Anëtarë të gjyqësorit që punojnë për të ndërtuar një sistem profesional, efikas, llogaridhënës dhe novator, dhe zbatuar praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Shërbimet: Udhëzime të qarta dhe praktike, mbështetje dhe instrumente që përmirësojnë ofrimin e shërbimeve gjyqësore, efikasitetin e administrimit të gjykatave, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe që sjellin përfitime të prekshme për qytetarët.

Shtrirja / Mbulimi: Një zë kombëtar i qëndrueshëm dhe i respektuar.

Partneriteti: Institucionet e sistemit të drejtësisë, degët e tjera të pushtetit, Media, partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë për zhvillim dhe shoqëria civile.

Përfituesit: Individët që gëzojnë të drejtën për një gjyqësor të drejtë dhe të pavarur, që është i aftë të ofrojë shërbime gjyqësore me cilësinë më të lartë.

- Përmes angazhimit në mënyrë proaktive dhe ofrimit të udhëheqjes së saj në proceset e hartimit të politikave, zhvillimit të planeve, marrjes së vendimeve kyçe dhe akordimit të burimeve të nevojshme për gjyqësorin.

- Përmes përdorimit të praktikave më të mira ndërkombëtare për zbatimin e masave me ndikim të lartë në çdo nivel, duke nisur me ngritjen e një Gjykate të Lartë funksionale.

- Përmes ofrimit të mbështetjes thelbësore drejtuesve të gjykatave, institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë, pushteteve të tjera qeverisëse dhe shoqërisë civile.

- Pikënisje e re, me zotimin për të krijuar marrëdhënie me nivel të lartë besimi dhe për të bashkëpunuar me vendimmarrësit kyçë.

- Kuptimi i drejtë i proceseve vendimmarrëse në gjyqësor dhe qeveri.

- Përvojë dhe ekspertizë të plotë dhe me rëndësi për sistemin gjyqësor.

- Aftësi në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me median dhe publikun, me qëllim për të ndikuar në mënyrë proaktive për të garantuar aksesin në drejtësi dhe të drejtën e informimit

- Ndërtimi i marrëdhënieve të ngushta dhe të qëndrueshme me një sërë partnerësh ndërkombëtarë dhe lokalë për zhvillim.

- Ngritja e një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe llogaridhënëse karshi vlerave tona dhe e përkushtuar për përmirësim të vazhdueshëm.

- Krijimi i strukturave dhe sistemeve të efektshme dhe efikase që shfrytëzojnë plotësisht aftësitë dhe profesionalizmin e anëtarëve të KLGJ-së.

- Formulimi i programeve të qarta për krijimin dhe administrimin e partneriteteve strategjike.

- Role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për palët e interesit.

- Aftësia për të ofruar shërbime që sjellin mbështetje të qëndrueshme financiare.

- Parametra për matjen e impaktit dhe efektshmërisë të punës sonë.

ANALIZA SWOT

Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet

Gjatë procesit të planifikimit strategjik, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e institucionit (përmes një analize SWOT). Ky proces siguroi informacion me vlerë, lidhur me çështjet aktuale dhe të mundshme, që mund të prekin KLGJ-në dhe gjyqësorin. Analiza SWOT i erdhi në ndihmë Këshillit të kuptojë më mirë kontekstin mjedisor, ndërkohë që anëtarët po marrin rolin e tyre si drejtues të gjyqësorit në Shqipëri.

KLJG-ja ka identifikuar zërat e mëposhtëm me tekst të theksuar, si çështje me përparësi.



PANORAMË E PËRGJITHSHME E SYNIMEVE STRATEGJIKE

Gjatë dy viteve të ardhshme, gjyqësori do t'i përqendrojë përpjekjet e tij në pesë synime strategjike parësore të cilat përputhen me vizionin, misionin, vlerat dhe kaskadën e strategjisë, të përcaktuar më lart.

Synimet dhe objektivat e përcaktuar në këtë plan janë ambicioze dhe përkufizojnë qëllimet e gjyqësorit deri në fund të vitit 2020.

Në planin e veprimit që po hartohet për ta shoqëruar këtë dokument, KLGJ-ja planifikon të përdorë një sërë matjesh dhe treguesish të performancës, për të vlerësuar ecurinë drejt secilit synim, si dhe drejt objektivave e strategjive të lidhura me to. Matjet e performancës do të monitorohen dhe përditësohen bazuar në evoluimin e objektivave dhe programeve. Do të mblidhen, shqyrtohen dhe analizohen të dhëna sasiore, dhe informacioni cilësor do të shqyrtohet, për të kuptuar më mirë impaktin e KLGJ-së.



SYNIMET STRATEGJIKE

KLJG-ja beson se, gjatë dy viteve të para, është e rëndësishme të tregojë vendosmëri për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të gjitha nivelet. Pesë synimet e mëposhtme janë hartuar me qëllim trajtimin e fushave me problematikat më urgjente.

SYNIMI 1: Përshejtimi i Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve

Sigurimi i burimeve të përshtatshme për zbatimin e reformave të pushtetit gjyqësor, përfshirë infrastrukturën dhe personelin gjyqësor, sa më shpejt të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi cilësisë.

Ne e pranojmë se, pas vitesh mosfunksionimi të duhur të sistemit gjyqësor dhe me një Gjykatë të Lartë jofunksionale, duhet të punojmë pa u lodhur për t'i trajtuar këto çështje përparësitë më urgjente të gjyqësorit.

SYNIMI 2: Përcaktimi dhe Zbatimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore

Angazhimi për zbatimin e praktikave më të mira për menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duke u përqendruar në standardet që sigurojnë ekselencë gjyqësore.

Ne e pranojmë se në të shkuarën, fjala ekselencë nuk mund të përdorej shpesh për të përshkruar gjyqësorin shqiptar. Teksa ecim përpara, zotohemi të sigurojmë që gjyqësori të ketë personel që përmbush standarde rigorozet etike, që ka njohuri të thella të legjislacionit shqiptar dhe që vlerësohet bazuar në standardet më të larta profesionale.

SYNIMI 3: Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funkcionimi më i Mirë i Gjykatave

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale.

Ne e kuptojmë që infrastruktura gjyqësore (ndërtesat dhe mjediset e punës) dhe sistemet e teknologjisë së informacionit janë vjetruar dhe janë shpesh jofunksionale. Zotohemi të bëjmë gjithçka është e nevojshme për të ngritur dhe mirëmbajtur një sistem funksional, efikas, të mirëadministruar dhe me integritet të lartë.

SYNIMI 4: Zhvillimi i Kapaciteteve të Brendshme të KLJG-së

Përcaktimi i qartë i rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe administratës së tij dhe dhënia përparësi fuqizimit institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë, përfshirë kërkimin e burimeve të përshtatshme buxhetore.

Zotohemi të hedhim themele të fuqishme për punën tonë. Kjo ka të bëjë me krijimin e strukturave dhe me plotësimin me personel që pasqyron vlerat e institucionit, përfshirë këtu një administratë të përbërë nga specialistët më të talentuar dhe të palodhur në administrimin e gjykatave.

SYNIMI 5: Hartimi i Strategjive të Efektshme për Komunikimin e Jashtëm

Përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve tanë dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi.

Zotohemi të veprojmë me transparencë duke siguruar që individit të jetë plotësisht i informuar mbi ndryshimet në gjyqësor.

Synimi 1: Sigurimi i burimeve të përshtatshme për zbatimin e reformave të pushtetit gjyqësor, përfshirë infrastrukturën dhe personelin gjyqësor, sa më shpejt të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi cilësisë.

Përshpejtimi i Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve

- 1.1 Bërja funksionale e Gjykatës së Lartë si prioritet emergjent, duke marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante në një kohë sa më të shpejtë.
- 1.2 Funksionalizimi i shpejtë i Gjykatës së Lartë nëpërmjet plotësimit të nevojave infrastrukturore dhe burimeve njerëzore.
- 1.3 Shpërndarja e drejtë e ngarkesës në gjykatat e vendit me qëllim rritjen e efikasitetit dhe aksesit për qytetarët, përmes riorganizimit të hartës gjyqësore në përpjesëtim të drejtë me ndarjen e re territoriale, popullsinë dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura gjyqësore.
- 1.4 Mbështetja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.
- 1.5 Reduktimi i çështjeve të mbartura në gjykatat e të gjitha niveleve, përmes hartimit të një plani pune.
- 1.6 Shfrytëzimi efikas i burimeve buxhetore për gjykatat.
- 1.7 Ngritja e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe mbështetja e fillimit të veprimtarisë së tyre.

Synimi 2: Angazhimi për zbatimin e praktikave më të mira për menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duke u përqendruar në standardet që sigurojnë ekselencën gjyqësore.

Përcaktimi dhe Zbatimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore

- 2.1 Rritja e transparencës në emërimet dhe promovimet e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, përmes sigurimit të standardeve të meritokracisë.
- 2.2 Përmirësimi i standardeve të etikës nëpërmjet hartimit dhe publikimit të standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes për magistratët dhe personelin e administratës së gjykatave.
- 2.3 Përcaktimi i procedurave dhe kritereve për masa dhe procese disiplinore të drejta, transparente dhe etike.
- 2.4 Ulja e vonesave në vlerësimin vjetor të performancës së gjyqtarëve dhe personelit të administratës së gjykatës.
- 2.5 Vendosja e standardeve në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe personelit të administratës gjyqësore.
- 2.6 Rritja profesionale e gjyqtarëve dhe administratës së gjykatës nëpërmjet ofrimit të mundësive të vazhdueshme për zhvillimin profesional.
- 2.7 Promovimi i përdorimit të masave alternative të dënimeve nga gjykatat.

Synimet Strategjike	Objektivat
<p>Synimi 3: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që zhvillojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale.</p> <p><i>Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funksionim më i Mirë i Gjykatave</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • 3.1 Rritja e efikasitetit, saktësisë së të dhënave dhe efektivitetit në menaxhimin e çështjeve gjyqësore nëpërmjet zhvillimit të një sistemi elektronik të unifikuar për menaxhimin e çështjeve sipas standardeve ndërkombëtare • 3.2 Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (ndërtesa dhe mjedise pune) për të përmbushur standardet bashkëkohore. • 3.3 Sigurimi i mirëfeksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave.
<p>Synimi 4: Përcaktimi i qartë i rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe administratës së tij dhe dhënia përparësi fuqizimit institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë, përfshirë kërkimin e burimeve të përshtatshme buxhetore.</p> <p><i>Zhvillimi i Kapaciteteve të Brendshme të KLGJ-së</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • 4.1 Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e reformës gjyqësore, ushtrimin e përgjegjësive nga ana e KLGJ-së me qëllim sigurimin e pavarësisë gjyqësore. • 4.2 Ngritja e strukturave përkatëse për ushtrimin e përgjegjësive të plota të KLGJ-së duke synuar qeverisjen e mirë të sistemit gjyqësor. • 4.3 Hartimi i përshkrimit të pozicioneve të punës dhe rekrutimi i kandidatëve për pozicione në administratë, sipas kriterëve të posaçme që përputhen me vlerat, synimet dhe objektivat e KLGJ-së. • 4.4 Ngritja e kapaciteteve të KLGJ-së për të monitoruar dhe vlerësuar punën e saj. • 4.5 Krijimi i një kulture novacioni që adreson zhvillimet në sistemin gjyqësor në Shqipëri. • 4.6 Ngritja e një sistemi transparent dhe të efektshëm për menaxhimin e performancës, i cili siguron që anëtarët e KLGJ-së dhe personeli administrativ të punojnë në kapacitetin më të lartë, si dhe që programet e strategjitë të sjellin rezultatet e pritshme (efektshme dhe efikase). • 4.7 Marrja e një roli aktiv në procesin e hartimit dhe përmirësimit të legjislacionit, me qëllim përmirësimin e (ndikimin) punës së gjyqësorit, apo (ndonjë) çështjeve të tjera brenda përgjegjësive të Këshillit. • 4.8 Hartimi, miratimi dhe zbatimi i planit strategjik për sistemin gjyqësor, në bashkëpunim me MD, me qëllim koordinimin për të gjithë sistemin e drejtësisë.

Synimet Strategjike	Objektivat
<p>Synimi 5: Përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve tanë dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi.</p> <p>Hartimi i Strategjive të Efektshme për Komunikimin e Jashtëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 5.1 Ofrimi dhe zbatimi i mënyrave novatore dhe të përshtatshme për palët e interesit, në veçanti përmes sistemeve online, për rritjen e bashkëpunimit të publikut me KLGJ-në, personelin administrativ dhe gjykatat. • 5.2 Marrja e një roli aktiv për të ndikuar politikat publike dhe për të nxitur ndryshimet e duhura specifike, lidhur me mënyrën se si pushtetet e tjera ndërveprojnë me KLGJ-në për planifikimin në sistemin gjyqësor. • 5.3 Hartimi i një strategjie komunikimi me qëllim vendosjen (sigurimin) e marrëdhënieve proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median. • 5.4 Rritja e transparencës për të gjithë sistemin gjyqësor nëpërmjet publikimit në kohë të vendimeve të gjykatave në faqen e internetit të KLGJ-së.

MONITORIMI, LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Struktura përgjegjëse për zbatim

Në hartimin e këtij plani strategjik për të gjithë sistemin gjyqësor në Shqipëri, Këshilli njihet rëndësinë që ka zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i kujdesshëm i veprimtarive të tij. Në përpjekjen për të prioritetizuar këto veprimtari, Këshilli angazhohet të krijojë një strukturë të posaçme që monitoron ecurinë e zbatimit të strategjisë përkundrejt objektivave të vendosur.

Kjo strukturë mundëson mbledhjen e të dhënave dhe informacionit të rëndësishëm në lidhje me zbatimin e strategjisë, dhe kur është e mundur sugjeron ndryshime në strategji, tregues dhe/ose instrumente matëse. Kjo strukturë ngrihet me urdhër të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku përcaktohet përbërja, përgjegjësitë dhe afatet kohore. Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë është një strukturë e përkohshme dhe me anëtarësi fluide, e cila caktohet në bazë të nevojave të Këshillit për mbikëqyrje. Duke qenë se objektivat dhe masat përkatëse mund të ndryshojnë në kohë, përbërja e kësaj strukture duhet të jetë e ndryshueshme. Megjithatë, ngritja e saj është domosdoshmëri institucionale që mundëson monitorimin e progresit, rishikimin e drejtimit strategjik dhe zbatimin e vetë strategjisë.

Raportimi periodik

Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë është njësi përgjegjëse që do të mbledhë të dhënat e nevojshme dhe do të përgatisë raportime periodike në lidhje me progresin e arritur në zbatimin e strategjisë së Këshillit. Ky monitorim i brendshëm, përveç vlerësimit të jashtëm, e pajis Këshillin me një instrument për monitorimin dhe kontrollimin e vetë sistemeve të brendshme, proceseve dhe progresit në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të parashtruar në planin strategjik. Struktura monitoruese do të jetë përgjegjëse për hartimin e raporteve të punës tremujore deri në përfundim të afatit të kësaj strategjie. Këto raporte do të synojnë të informojnë Këshillin mbi ecurinë në zbatimin e strategjisë, si dhe të përqendrojnë vëmendjen në ato çështje që mund ta pengojnë zbatimin.

Në funksion të matjes së rezultateve, struktura e monitorimit të strategjisë do të hartojë dy herë në vit (çdo gjashtë muaj) një matricë vlerësimi që shpjegon më tej progresin në zbatimin e strategjisë, apo, sipas rastit, arsyet për devijimin nga plani i miratuar i veprimit. Duhet vënë në dukje se Këshilli i kushtoi një vëmendje të madhe zhvillimit të treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë për secilin zë të planit strategjik dhe të planit të veprimit, dokumenti strategjik dhe plani i veprimit ka treguesit e progresit të cilët do të jenë tregues impakti në rastin e objektivave dhe tregues rezultati në rastin e aktiviteteve. Shumë prej këtyre treguesve pasqyrojnë qëllimisht treguesit e parashikuar në Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë me qëllim bashkërendimin e punës. Këto tregues do të drejtojnë strukturën e monitorimit për matjen e progresit gjatë procesit të vlerësimit dhe monitorimit.

Publikimi dhe rishikimi

Struktura e monitorimit do të jetë përgjegjëse për dorëzimin e të gjitha raporteve për rishikim dhe miratim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Të gjitha raportet do të bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit do të jetë përgjegjës për rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo vit për të garantuar përputhshmërinë me zhvillimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë.

Shtojca A: Pjesëmarrësit në Procesin e Planifikimit Strategjik

Hartimi i këtij Plani Strategjik nuk do të kishte qenë i mundur pa angazhimin e jashtëzakonshëm të një grupi të ndërthurur pjesëmarrësish:

ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Naureda Llagami, Kryetare
Maksim Qoku, Zëvendës Kryetar
Alban Toro
Brikena Ukperaj
Brunilda Kadi
Dritan Hallunaj
Erjon Muharremaj
Fatmira Luli
Ilir Toska
Marcela Shehu
Medi Bici

STAFI DREJTUES I ADMINISTRATËS SË KLGJ-së

Luljeta Laze, Drejtore e Buxhetit
Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Administratës

Këshilli dhe stafi i tij administrativ vlerësojnë kontributin dhe asistencën që anëtarët e gjyqësorit, të cilët përfaqësonin të gjitha instancat e gjykatave, ato të juridiksionit të përgjithshëm, administrativ dhe të krimeve të rënda, dhanë gjatë hartimit të këtij plani. Presim me padurim një pjesëmarrje akoma më të madhe në procesin e planifikimit të radhës për 2021-2023.



Këshilli i Lartë Gjyqësor

WWW.KLGJ.AL